

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i aksesit në internet për një periudhë dy vjeçare”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

72400000-4 - Shërbimet e internetit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,900,600 (tre milion e nëntëqind mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 16/2024, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1,500,000 (nje milion e pesëqind mije) Lekë.

- *Kur ofertohet per Lotin 1, duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 900,000 (nenteqind mije) Leke.*
- *Kur ofertohet per Lotin 2 duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 600,000 (gjashtëqind mije) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros te jete afërsisht ne masen maksimale per secilin Lot.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 700,000 (shtateqind mijë) Lekë.

- *Kur ofertohet per Lotin 1, duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 400,000 (katërqind mije) Leke.*
- *Kur ofertohet per Lotin 2 duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 300,000 (treqind mije) Leke.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar për secilin Lot, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues (për njerin nga lotet që oferton) duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për periudhën 3 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës duhet të jetë jo më pak se 5 (pese). Për të provuar këtë pikë, OE ofertues duhet të disponojë listepagesat përkatëse për periudhën e kërkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE, e cila ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi. Ky shërbim është i rëndësishëm për OST sh.a duke pasur parasysh edhe rëndësinë e vecantë që ka përdorimi i internetit si infrastrukturë komunikimi ndërmjet entiteve qëndrore me ato lokale të OST sh.a. por edhe lidhjet me jashtë OST, për këtë është kërkuar një shërbim i vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë /24 orë dhe në 7 ditë të javës. Kompania është e detyruar të ofrojë shërbim teknik të nevojshëm pranë OST sh.a. dhe për këtë është e nevojshme numri i punonjësve përgjegjës për mirëmbajtjen me efikasitet të kësaj lidhjeje.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues (per njerin nga lotet qe oferton) duhet të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE NCC (European IP Networks).*

2.3.4 *Numri aktual i “Peer” që operatori ekonomik ofertues (per njerin nga lotet qe oferton) duhet të disponojë nuk duhet të jetë më i vogël se 15 (sipas RIPE NCC database ose <http://bgp.he.net/>), gjithashtu duhet që të ketë të paktën (2) dy “Peer” me një provider AS, të regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë.*

Argumentimi: Kerkesat e mersiperme jane te rendesishme pasi objekti i prokurimit perfshin shtete te ndryshme ne bashkepunim me njeri-tjetrin. Per kete eshte e nevojshme te marreveshja e bashkepunimit si dhe detyrimi ligjor per licencen e AKEP. Kerkesat e mesiperme jane te rendesishme per te garantuar disponueshmerine dhe qendrueshmerine e sherbimit te aksesit internetit ne nivel nderkombetar, si dhe ofrojne siguri dhe stabilitet te sherbimit te Internetit.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues (per njerin nga lotet qe oferton) duhet të jetë e regjistruar pranë regjistratit të AKEP për ofrimin e shërbimit, për këtë të paraqesë autorizimin përkatës per Radio Link me frekuence te licensuar AKEP 12/13 Ghz, meqenese infrastruktura ekzistuese qe disponon Autoriteti Kontraktor është mbështetur mbi këto breza. Megjithatë, do të pranohet edhe që OE ofertues të paraqesë autorizimin përkatës per Radio Link me frekuence te licensuar AKEP -38 Ghz, me kushtin që OE ofertues të marrë përsipër (me nje deklarate) qe të ngrejë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij shërbimi, në përputhje me Specifikimet Teknike.*

Argumentimi: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare eshte institucioni i cili leshon lejen per shfrytezimin e brezit te frekuencave. Ky autorizim kerkohet per arsyen qe Radio Link mos te kete interferenca me radio te tjera.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori Ekonomik ofertues (per njerin nga lotet qe oferton) duhet te kete stafin e certifikuar si me poshte:*

- ✓ 1- Specialist te certifikuar si CCNA/ose ekuivalent
- ✓ 1- Specialist te certifikuar si SCTE/ose ekuivalent

✓ *1- Specialist te certifikuar per Sigurine Kibernetike /ose ekuivalent
Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikim.*

Per te permbushur kete pike, OE ofertues duhet te dispunoje kontratat e punes me punonjesit e mesiperm, certifikimet dhe listepagesat e 3(tre) muajve te fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE, e cila ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi.

Specialist te certifikuar si CCNA/ose ekuivalent – Certifikimi per CCNA ose ekuivalent deshmon qe OE ka staf te certifikuar per administrim rrjeti.

Specialist te certifikuar si SCTE/ose ekuivalent – Certifikimi per SCTE ose ekuivalent deshmon qe OE ka staf te certifikuar ne nivel profesional.

Specialist te certifikuar Sigurine Kibernetike/ose ekuivalent – Certifikimi deshmon qe OE ka staf te certifikuar ne nivel sigurie per administrim rrjeti.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues (per njerin nga lotet qe oferton) qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ✓ **ISO 9001:** *certifikatën e menaxhimit të cilësisë së shërbimit, që kanë lidhje me objektin e kontratës;*
- ✓ **ISO 27001:** *për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, në lidhje me objektin e kontratës,*
- ✓ **ISO 14001:** *për sistemin e menaxhimit mjedisor, në lidhje me objektin e kontrates.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel nderkombetar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilesise të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipercituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilesisë. Plotesimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001: është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur dhe Kontraktori objekt procedure prokurimi, duhet të nderhyjë në sistemin e brendshëm të AK. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

Standardi i menaxhimit të cilesise së mjedisit ISO 14001: është kërkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues është i kujdesshëm ndaj mjedisit, duke menaxhuar ndikimin në mjedis që mund të ketë kryerja e punimeve objekt mbikeqyrjeje.

AK duhet të marrë çdo masë të nevojshme për parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarisë së saj, ku për shkak të moscertifikimit të duhur të kontraktoreve, AK duhet të pezullojë ose të vonojë veprimtarinë e saj, duke shkaktuar një dëm të madh në sistemin elektro energjitik shqiptar, ku është edhe objekti i saj kryesor.

2.3.8 *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim teknik të shoqëruar me skemat e rrjetit të ofertuesit, për zgjidhjen teknike për ofrimin e shërbimit si dhe planin e back-up për ofrimin e shërbimit, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim (routing) të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim.*

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe i shërben AK që këto besueshmëri që OE ofertues ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas përcaktimeve të bëra në Termat e Referencës.

2.3.9 *Ne funksion të plotësimin të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues (për njërin nga lotet që oferton) duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amesi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.